



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.10.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Enver Roshi – Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me grupet e interesit për të drejtat në punë të rinjve.

Marrin pjesë:

Enver Roshi, Klodiana Spahiu, Ilir Pendavinji, Edlira Bode, Adelina Rista, Almira Xhembulla, Ardiana Jaku, Florenc Spaho, Amra Barova, Majlinda Halilaj, Eugen Bojaxhiu, Koçi Tahiri, Edmond Stojku, Ervis Meço dhe Halil Jakimi.

Mungon:

Arben Kamami, Klotilda Bushka dhe Roland Xhelilaj.

Të ftuar:

Dajna Sorensen - Zëvendësministrja e Financave

Irida Qosja - Përfaqësuese e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore

Eda Brahimaj - Përfaqësuese e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore

Edison Hoxha - Drejtor Ekzekutiv i Qendrës për të Drejtat në Punë

Eneida Mjeshtri - Përfaqësuese e Qendrës për të Drejtat në Punë

Angjelo Ahmati – Aktivist Rinor

Kiara Laze – Aktiviste Rinore

Dea Ndreu – Aktiviste Rinore

Ada Hajderlli – Aktiviste Rinore

Jyrgen Troka – Aktivist Rinor

Erti Poka – Aktivist Rinor

Fëllënxa Uka – Aktiviste Rinore

Nikollaq Zhezha – Aktivist Rinor

Mirsada Kuka – Aktiviste Rinore

Doela Hoxhaj – Aktiviste Rinore

Samanta Lutaj – Aktiviste Rinore

Flogerta Driza - Aktiviste Rinore

Ervin Kurti – Fotograf i Qendrës për të Drejtat në Punë

HAPET MBLEDHJA

Enver Roshi – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Qendra për të Drejtat në Punë ka paraqitur një kërkesë, ku ka kërkuar një interpelancë të improvizuar për bashkëpunim lidhur me zhvillimin e aktivitetit për të drejtat në punë të të rinjve në kuadër të javës “Të rinjtë për punë të denjë”.

Në kërkesën thuhet: “Në kuadër të fushatës 1-javore të organizuar nga Qendra për të Drejtat në Punë (“Ballë lartë” dhe “Të rinjtë për punë të denjë”), që është parashikuar të zhvillohet në datat 7-14 tetor me mbështetjen e Olof Palme International Center, CRL ka parashikuar të zhvillojë një sërë aktiviteteve. Në kuadër të këtyre aktiviteteve, është parashikuar të zhvillohet edhe një interpelancë e improvizuar në ambientet e Komisionit të Shëndetësisë të Kuvendit të Shqipërisë, ku përballë anëtarëve të komisionit do të jenë një grup të rinjsh përfaqësues të organizatave rinore, aktivistë dhe sindikalistë të rinj të angazhuar në të drejtat e punës në Shqipëri. Në fokus të kësaj interpelance të improvizuar do të jenë të rinjtë dhe të drejtat e tyre në punë”.

Kjo është edhe axhenda për sot, e cila ka disa objektiva, të cilat do t’i prezantoj më poshtë.

Të ftuar nga Qendra për të Drejtat në Punë sot kemi zotin Edison Hoxha, drejtor Ekzekutiv i Qendrës për të Drejtat në Punë; zonjën Eneida Mjeshtri, përfaqësuese e Qendrës për të Drejtat në Punë; si dhe aktivistët rinorë: Angjelo Ahmati, Kiara Laze, Dea Ndreu, Ada Hajdërlli, Jyrgen Troka, Erti Poka, Fëllënxa Uka, Nikolla Zhezha, Mirsada Kuka, Doela Hoxhaj, Samanta Lutaj, Flogerta Driza, si dhe fotografën e Qendrës për të Drejtat në Punë, zotin Ervin Kurti.

Gjithashtu, të ftuar kemi zëvendësministren e Financave, zonjën Dajna Sorensen; si dhe zonjat Irida Qosja dhe Eda Brahimaj, përfaqësuese të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore

Atëherë, do t’i hap fjalën përfaqësuesit të Qendrës për të Drejtat në Punë për të bërë një prezantim të aktivitetit dhe të mënyrës se si të gjithë objektivat e vendosur këtu do t’i zhvillojmë në komisionin tonë në seancat e interpelancave të improvizuara.

Fjala për ju, zonja Eneida.

Eneida Mjeshtri – Falënderoj të gjithë deputetët pjesëmarrës në këtë seancë dëgjimore, të cilën e kemi kërkuar në një kohë rekord!

Dua të falënderoj këtë Kuvend dhe kryetarin e këtij komisioni, i cili mori përsipër organizimin e kësaj seance dëgjimore! Gjithashtu, dua të falënderoj shumë edhe zëvendësministren e Financave, zonjën Sorensen, si dhe përfaqësueset e nderuara të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, me të cilat kemi pasur një bashkëpunim të gjatë ndër vite!

Falënderimi im është shumë i ndjerë edhe për të rinjtë që ndodhen këtu. Ne do të përpiqemi të adresojmë disa çështje dhe duam të shprehim para jush shqetësime dhe problematika që qendra jonë ka mundur t'i mbledhë nëpërmjet një pune studimore dhe diskutimeve në terren me të rinjtë.

Kjo është fushata e parë që bëhet në Shqipëri me të rinjtë. Kryesisht kjo fushatë bëhet jo vetëm për nxitjen e punësimit të të rinjve, por për punësimin e denjë të tyre, pra për të rinjtë dhe punën e denjë. Deri tani ka pasur një angazhim serioz të qeverisë, kryesisht të të gjitha qeverive shqiptare për të nxitur punësimin e të gjitha grupeve shoqërore. Kuptohet që të rinjtë, njëloj si edhe gratë, janë grupe të marginalizuara ose grupe që kanë nevojë për vëmendje të veçantë, por është bërë pak në drejtim të standardeve të punës, në drejtim të axhendës së punës së denjë, e cila është një detyrim i qeverisë shqiptare që rrjedh nga anëtarësimi i saj në organizatat ndërkombëtare të punës.

Axhenda e punës së denjë ka 4 shtylla kryesore veprimi: nxitja e punësimit, standardet e punës, ku futen siguria dhe shëndeti në punë, si dhe dialogu social, që është po aq shumë i rëndësishëm. Ne dëshirojmë fillimisht të shprehim se kjo axhendë duhet absolutisht të forcohet dhe duhen marrë masa institucionale, nëpërmjet të gjitha institucioneve të linjës, por edhe atyre monitoruese të ligjit, me qëllim që këto shtylla veprimi të axhendës së punës së denjë të zbërthehen në masa konkrete, në strategji konkrete veprimi, që t'u mundësojnë të rinjve punë të denjë, punë me standarde, punë me siguri profesionale, me mundësinë për pagesë të denjë, me mundësinë për të punuar në kushte të denja pune dhe pagese, por edhe me mundësinë e madhe për t'u zhvilluar profesionalisht.

Ju e dini që të rinjtë e kanë të vështirë të punësohen për shkak se shpeshherë nuk e kanë eksperiencën e nevojshme të punës dhe për këtë arsye ata anatemojnë nga punëdhënësit. Gjithashtu, ata që punësohen me paga më të ulëta, vuajnë shpeshherë edhe largimet padrejta nga puna. Në fakt, ky ishte edhe qëllimi i kësaj seance dëgjimore, në mënyrë që ne të përballemi me të rinjtë tanë, të cilët vijnë nga organizata të ndryshme rinore, me të cilat Qendra për të Drejtat në Punë ka punuar ngushtësisht për ngritjen e kësaj fushate kombëtare "Për të rinjtë dhe punën e denjë". Unë dua të përmend disa prej këtyre organizatave, të cilat janë të përhapura në të gjithë Shqipërinë, të tilla si: "Lëvizja rinore" në Pukë, "Epoka e re" në Fier, "Qendra

rinore” në Vlorë, “Qëndresa qytetare”, shoqata “Për integrimin e zonave informale” në Kamëz, si dhe Qendrën për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në Durrës. Pra, të gjitha këto organizata kanë sot këtu përfaqësuesit e tyre.

Edhe një herë faleminderit që mundësuat ardhjen tonë këtu!

Unë dua t’i jap fjalën secilit prej të rinjve për të sjellë eksperiencën personale, por edhe eksperiencën të ndryshme të qendrave që ata përfaqësojnë. Gjithashtu, dëshiroj që nëpërmjet kësaj seance tepër miqësore ata të adresojnë edhe shqetësimet e tyre.

Enver Roshi – Faleminderit!

Unë do t’u lutesha të ftuarve që në vetëm 3 minuta të bëjnë një prezantim të shkurtër.

Fjalën e ka aktivisti Angjelo Ahmati, i cili do të flasë për këshillimin e karrierës dhe zhvillimin e kurrikulave parauniversitare dhe universitare për të drejtat në punë.

Angjelo Ahmati - Përshëndetje!

Unë do të mundohem që shkurtimisht të paraqes në disa pika këshillat dhe sugjerimet që kemi studiuar, në mënyrë që t’u lë kohë edhe kolegeve për të parashtruar idetë e tyre. Kryesisht, unë dua të flas për problemet që hasin të rinjtë, qoftë gjimnazistët në gjimnaze, ashtu edhe studentët në universitete për sa i përket edukimit dhe këshillimit të karrierës.

Edukimi i karrierës është një lëndë, e cila jepet në gjimnaz që në vitin e parë. Realisht, duke qenë se unë sot kam marrë përsipër të prezantoj pikërisht këtë lëndë, mund të them se ekziston një problem i madh. Unë mendoj se stafi që e jep këtë lëndë në gjimnaze, nuk është i denjë dhe i kualifikuar për ta dhënë ashtu siç duhet këtë lëndë. Deri në momentin që ne flasim, këtë lëndë në gjimnaze më shumë e japin mësues të lëndëve të anglishtes ose të letërsisë. Unë mendoj se kjo nuk është shumë përfituese për gjimnazistët. Gjithashtu, dua të shtoj një fakt tjetër. Universitetet private, të paktën deri tani, kanë zyra të edukimit të karrierës. Zyrat e edukimit të karrierës normalisht informojnë studentët se çfarë pune mendojnë ata se mund ta bëjnë më mirë apo ku e gjejnë ata veten se janë më mirë, por kjo gjë nuk ndodh në universitetet shtetërore. Unë mendoj se ky është një problem i madh, sepse, edhe në qoftë se në universitetet shtetërore ekzistojnë zyrat e karrierës, ato nuk funksionojnë mirë. Unë mendoj se kjo gjë mund të zgjidhet, duke krijuar politika publike megjithëse kërkohet një studim më i gjerë, pasi duhet të bëhen bashkë disa institucione për ta studiuar këtë problem. Unë mendoj se ky problem duhet të zgjidhet, sepse realisht po i përndjek shqiptarët, pasi ka shumë studentë të mirë, të cilët, edhe pse studiojnë shumë, nuk kanë informacione të gjera rreth edukimit të karrierës. Ky problem vjen nga gjimnazi, nga lënda e edukimit të karrierës, sepse nuk ushtrohet mirë në gjimnaze për shkak të stafit jo të kualifikuar, por edhe për shkak të mosvëmendjes nga të rinjtë, pasi e quajnë si lëndë dytësore, thjesht si një lëndë për të plotësuar kreditet. Nuk e di a isha i qartë.

Faleminderit!

Enver Roshi – Ju ishit shumë i qartë dhe mesazhi që ju dhatë ishte i qartë edhe për anëtarët e komisionit. Unë mendoj se ky problem lidhur me karrierën duhet të adresohet edhe te Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, sepse ai komision merret me edukimin shkollor, me kurrikulat, me programet e të tjera probleme si këto.

Angjelo Ahmati - Unë mendoj se duhet bërë një studim më i gjerë.

Enver Roshi – Faleminderit!

Fjalën e ka aktivisti Nikollaq Zhezha, i cili do të flasë për punësimin informal, në shkelje të dispozitave ligjore të punës, të të rinjve të punësuar në sektorin e turizmit, kryesisht si punësim sezonal.

Nikollaq Zhezha – Përshëndetje!

Një numër i madh i të rinjve janë të punësuar në sektorët e shërbimit dhe turizmit, kryesisht në punë sezonale gjatë sezonit të verës dhe të turizmit.

Enver Roshi – Më falni, zoti Nikollaq, a mund të bëni një prezantim, nëse ju jeni student apo i punësuar?

Nikollaq Zhezha – Unë aktualisht jam student në vitin e dytë dhe nuk jam ende i punësuar në sektorin e turizmit.

Enver Roshi – Për çfarë studioni?

Nikollaq Zhezha – Unë studioj në degën Menaxhim Biznesi.

Enver Roshi – Këtë prezantim të shkurtër e kërkoj nga të gjithë këtu.

Po, mund të vazhdoni.

Nikollaq Zhezha – Faleminderit!

Atëherë, siç e thashë, një numër i madh i të rinjve punësohen në punë sezonale gjatë sezonit turistik, në sektorin e shërbimeve. Në këtë sektor ka shumë probleme, disa prej të cilave janë: puna nën moshën ligjore, mungesa e kontratave, mungesa e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, gjithashtu, edhe kushtet e punës lënë shumë për të dëshiruar. Një problem i madh është edhe puna në të zezë. Kërkesa jonë si qendër lidhur me këtë problem është që Inspektorati i Punës të bëjë kontrolle maksimale, të reagojë dhe të marrë masa, si dhe të gjitha masat e marra t'i publikojë në mënyrë periodike.

Faleminderit!

Enver Roshi – Faleminderit, zoti Nikollaq!

Lidhur me problematikën që ngritët, besoj se Inspektorati i Punës dhe zëvendësministrja këtu i kanë shënuar.

Për të folur për sigurinë dhe shëndetin në punë me fokus sektorët, ku punësohen të rinjtë dhe për shkeljen e të drejtës së organizimit do të flasë aktivistja shoqërore, zonja Flogerta Driza, ish-e punësuar në *call center*.

Atëherë, si fillim mund të na thoni çfarë shkolle keni mbaruar dhe ku punoni aktualisht?

Flogerta Driza – Përshëndetje të gjithëve!

Unë quhem Flogerta Driza dhe kam përfunduar studimet master për përkthim dhe interpretim të gjuhëve angleze dhe italiane. Kam punuar për një kohë të gjatë në *call center*, por, fatmirësisht, jam shkëputur nga ky ngërç shumë i gjatë prej 6 apo 7 vjetësh.

Unë dua të paraqes këtu dy problematika, që hasen shpesh në qendrat *call center*. E para, është e drejta për organizim, dhe, e dyta, është siguria dhe shëndeti në punë. Të drejtën për organizim dua ta paraqes shumë shkurt. Kryesisht, kjo e drejtë nuk u jepet të rinjve, ose u mohohet që në momentin e parë kur nis një organizim nga ana e tyre për të shfaqur pakënaqësitë në punë. Kjo do të thotë se që në momentin e parë, kur rinjtë vendosin të organizohen lidhur me pakënaqësitë apo problematikat që ata hasin në punë, menjëherë punëdhënësi merr masa që kjo gjë të mos bëhet e mundur, duke kërcënuar të rinjtë me pushim të menjëhershëm nga puna dhe në këtë mënyrë të rinjtë tërhiqen.

Ndërkohë, një tjetër problem shumë i rëndësishëm është edhe siguria e shëndetit në punë, kryesisht në qendrat e *call center*. Unë dua ta theksoj fort këtë gjë, sepse nuk ekziston fare mjeku i ndërmarrjes, ose është thjesht formal. Ai vjen vetëm në qoftë se është rasti për të konfirmuar raportet mjekësore të punonjësve, ndërkohë që kjo kompetencë nuk i takon atij, por ai vjen vetëm sepse paguhet nga punëdhënësi në këtë rast.

Disa probleme të tjera kanë të bëjnë me sëmundjet profesionale, që shkaktohen nga puna në *call center*.

Atëherë, unë mendoj disa kontrolle mjekësore për sytë, veshët, kordat zanore dhe shtyllën kurrizore duhen të bëhen të detyrueshme të paktën 1 herë në 6 muaj, sepse është një punë konstante dhe kërkon një angazhim të jashtëzakonshëm të këtyre shqisave. Ndërkohë, kjo punë sjell probleme edhe nga ana mendore. Ata që nuk kanë eksperiencë dhe nuk kanë punuar asnjëherë në *call center* nuk e dinë se kjo punë shkakton probleme të tilla si: paraliza faciale, që ndodh kryesisht te femrat, ankth, depresion, mungesë përqendrimi, *overload*, që ka të bëjë me mbingarkesën e stresit në punë. Kjo ngarkesë më vonë sjell shumë probleme të tjera në marrëdhëniet e individit me familjen, me shoqërinë, në marrëdhëniet punëdhënës-punëmarrës e të tjerë. Unë uroj asnjë i ri të mos e provojë këtë lloj pune, sepse është vërtet një punë që sjell më vonë shumë pasoja. Unë vij nga një eksperiencë e gjatë punë në *call center*, pasi nuk kam punuar vetëm në një vend, por në disa vende.

Gjithashtu, unë kërkoj që të merret parasysh organizimi i të rinjve në punë, si dhe siguria e shëndetit në punë të mos jetë thjesht formale, por të jetë aktuale. Për ta arritur këtë është shumë e rëndësishme që të zvogëlohen disa burokraci, sidomos për të drejtën e organizimit. Pra, në qoftë se punonjës të ndryshëm duan të organizohen për t'u dhënë zë të drejtave të tyre, është e rëndësishme të shmangen burokracitë, sidomos nga Inspektorati i Punës. Kjo është kërkesa ime.

Enver Roshi – Për cilat burokraci e keni fjalën?

Flogerta Driza – Mund të jap raste konkrete, për shembull, kur mua më pushuan padrejtësisht nga puna në një qendër *call center* unë i hodha në gjyq dhe e fitova çështjen në shkallë të parë, por prej 4 vjetësh çështja ime është në Gjykatën e Apelit. Kjo situatë është zgjatur shumë për shkak të burokracive të ndryshme, por kjo është pjesë e gjykatës. Kurse për sa u përket ankesave, që paraqiten në Inspektoratin e Punës, kjo është problem, sepse ka shumë burokraci të tilla me letra dhe shkresa pa fund, që e bëjnë ankuesin të tërhiqet. Pra, jo të gjithë jemi të përgatitur për të bërë shkresa zyrtare apo dokumente zyrtare, ndaj unë kërkoj procedura më të lehta dhe më të thjeshta për punëmarrësin, në mënyrë që të shfaqin ankesat e tyre pranë Inspektoratit të Punës.

Enver Roshi – Ju me të drejtë ngritët një problem për të drejtën për organizim që nuk u jepet.

Flogerta Driza – Po, sepse ne përçahemi.

Enver Roshi – Në këtë rast nuk ka të bëjë Inspektorati i Punës, sepse bëhet fjalë për marrëdhënien midis të punësuarve dhe drejtuesve të tyre.

Flogerta Driza – Po, e drejtë, por ne kërkojmë të kemi njëfarë mbrojtjeje që të jepet garancia dhe mbrojtja në punë.

Enver Roshi – Faleminderit!

Atëherë, fjalën e ka aktivistja Dea Ndreu, e cila do të flasë lidhur me diskriminimin gjinor në marrëdhëniet e punës dhe eliminimin e çdo lloji forme ngacmimi karshi vajzave të reja.

Dea Ndreu – Përshëndetje!

Unë quhem Dea Ndreu dhe kam përfunduar studimet bachelor për Sociologji dhe masterin për psikologji këshillimi. Unë doja të adresoja dhunën dhe ngacmimin e vajzave të reja në botën e punës, duke marrë shkas edhe nga ratifikimi i fundit që ka bërë Organizata Botërore e Punës, e cila nuk është implementuar ende në Shqipëri. Konventa me nr. 190 është 100% e saktë dhe ne kërkojmë nga Kuvendi ratifikimin sa më parë të kësaj konvente, si dhe implementimin e saj në të ardhmen.

Faleminderit!

Enver Roshi – Pra, ju kërkon ratifikimin e konventës nr. 190...

Dea Ndreu – Po, ne kërkojmë ratifikimin e konventës me nr. 190 të Organizatës Botërore të Punës.

Enver Roshi – Dakord! A e keni depozituar konventën?

Eneida Mjeshtri – Kjo është konventa më e re që ka bërë ILO-ja në qershor të këtij viti nëpërmjet kongresit të saj ndërkombëtar. Bëhet fjalë për konventën nr. 190, që ka të bëjë me dhunën dhe ngacmimet e vajzave të reja në botën e punës, pra është një term më i gjerë se në vendin e punës. Në fakt, kjo është hera e parë që ne kërkojmë ratifikimin e një konvente. Në kemi nisur një nismë dhe Inspektorati i Punës është në dijeni të kësaj nisme. Kjo është një nismë e qendrës dhe e të gjitha organizatave të shoqërisë civile, bashkë me sindikatat më progresiste në vend, me qëllim që të nxisim sa më shpejt ratifikimin e kësaj konvente, që të kemi mundësi më pas të kalojmë në plotësimin me akte ligjore dhe nënligjore në zbatim të kësaj konvente.

Enver Roshi – Besoj se këtu nuk bëj ndonjë gabim të shpreh se komisioni ynë do ta votojë njëzëri këtë konventë, sapo ajo të vijë në Kuvend.

Atëherë, kalojmë te njohja e praktikës dhe vullnetarizmit si kohë/eksperiencë pune të prezantuar nga aktivistja rinore, Ada Hajdërlli.

Ada Hajdërlli – Përshëndetje!

Unë quhem Ada dhe jam studente në degën e Psikologjisë. Një problem tepër i rëndësishëm, me të cilin të rinjtë hasen, është se për të fituar një vend pune atyre u nevojitet eksperiencia e punës dhe kjo për ta është shumë e vështirë. Në vitin 2016 është miratuar nga Kuvendi ligji i vullnetarizmit, ku thuhej që pas 3 muajsh të dilnin edhe aktet ligjore, mirëpo këto akte nuk kanë dalë akoma, kështu që ne kërkojmë që këto nënakte ligjore të vendosen dhe në këtë mënyrë të rinjtë do të jenë më të motivuar për të kryer punë vullnetare, ato do të rriten profesionalisht, si dhe do ta kenë më të lehtë për të përfituar një vend pune.

Kërkojmë, gjithashtu, që këto të përfitohen, të zbatohen si në sektorin privat, ashtu edhe në atë shtetëror.

Faleminderit!

Enver Roshi - Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Koka!

Erti Koka - Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar aktivistë,

Jam student në degën e drejtësisë në Universitetin e Tiranës.

Do të doja të prekja çështjet e adresimit profesional në punësim të cilat janë një problem shumë i madh për të rinjtë, por edhe punëtorët të cilët kanë eksperiencë pune.

Ekziston një standard ndërkombëtar i përditësimit të punonjësve të cilët marrin trajnime, aftësohen profesionalisht dhe realisht ky ka qenë një ndër problemet më të mëdha të cilat kemi hasur në punësimin e të rinjve, sepse në momentin që të rinjtë punësohen, nuk përditësohen me të rejat e fundit që vijnë edhe nga bota dhe nuk marrin trajnimet e duhura. Ndërkohë, kjo është një e drejtë e të rinjve dhe një detyrim i punëdhënësve.

Në fakt, duke qenë se për një kohë të gjatë është ndjerë si mungesë, ndihet edhe si nevojë për t'u kërkuar që të rinjtë të kenë mundësi të trajnohen dhe të marrin të gjitha përditësimet që vijnë edhe nga jashtë vendit.

Faleminderit!

Enver Roshi - Faleminderit!

Në lidhje me mungesën e informimit dhe transparencës në zbatimin e ligjit që ofron incentiva për kompanitë që punësojnë të rinj.

Kjara Laze – Jam studente në vitin e tretë Juridik. Problemi për të cilin do të flas lidhet drejtpërdrejt me ne si studentë dhe unë personalisht, në momentin kur kam kërkuar për t'u punësuar apo për të pasur një vend pune që i përshtatet arsimit tim dhe eksperiencës që kam, ka ndodhur që disa kompani të punësojnë studentë pa eksperiencë dhe shteti i ndihmon ata në njëfarë mënyre, qoftë në pagesën e trajnimit të tyre apo edhe pjesën e uljes së taksave apo tatimeve (diçka e tillë). Ndërsa në disa kompani të tjera kjo nuk zbatohet fare.

Së pari, ne nuk kemi informacion se çfarë të drejte kemi dhe a ekziston apo jo një gjë e tillë.

Duke mos pasur informacion nuk dimë as çfarë të kërkojmë.

Enver Roshi - Faleminderit!

Edison Hoxha – Unë jam përfaqësues i qendrës.

(Diskutime pa mikrofon)

Incentivat bëhen publike. Në qoftë se ka një fond të dispozicion që i shërben SHKP-së për të incentivuar punësimin e të rinjve, atëherë kjo duhet të jetë transparente, procedura duhet të bëhet publike para se kjo të vihet në zbatim.

Nëse nuk zbatohet, ne duhet të punojmë bashkërisht dhe të shohim çfarë mund të bëjmë, që kjo të zbatohet dhe për më tepër kjo duhet të zgjerohet.

Në këtë VKM përcaktohet që të rinjtë janë 16-29 vjeç, ndërkohë që sipas standardeve të BE-së të rinjtë janë 16-34 vjeç.

Enver Roshi - Faleminderit!

Ju falënderoj të gjithëve për diskutimet tuaja! Shihet se problemi i punësimit të të rinjve në Shqipëri, me gjithë arritjet që ka, akoma ka të meta që vinë nga punëdhënësit më shumë, por edhe nga mungesa e organizimit të të rinjve. Gjithsesi kjo asnjëherë nuk është e mjaftueshme për të gjetur arsye. Legjislacioni ekzistues është, por shpeshherë ai nuk zbatohet.

Unë e hap këtë debat midis anëtarëve të komisionit dhe juve.

Nga Ministria e Financave, fjala për zëvendësministren.

Dajna Sorensen – Përshëndetje të gjithëve!

Faleminderit Qendrës dhe gjithë të rinjve që shprehën opinionet e tyre.

Unë do të përqendrohem më tepër te pjesa që ka të bëjë me punësimin dhe aftësimin profesional dhe ndoshta në një moment të dytë mund t'ia kalojmë fjalën edhe Inspektoratit të Punës për çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë dhe shëndetin në punë, pjesën e kontratave apo punësimit informal sidomos në sektorin e turizmit, që ka qenë shumë në fokusin e ministrisë sonë dhe Inspektoratit të Punës në veçanti.

Për sa u përket programeve të nxitjes së punësimit theksoj se këto programe në parim janë të konceptuara si programe në mbështetje të punësimit të të rinjve dhe nuk janë incentiva financiare për biznesin. Nuk duhet të jenë asnjëherë të tilla, pavarësisht se kemi një historik ku punëdhënësit janë ata të cilët në mënyrë të vazhdueshme kanë qenë aplikantët për sa u përket këtyre fondeve.

Me miratimin e ligjit të ri “Për nxitjen e punësimit” po e ndryshojmë radikalisht procesin e zbatimit të programeve të nxitjes, ku në qendër nuk është më biznesi, por është individi.

Duhet pasur parasysh se programet e nxitjes së punësimit targetohen për ata që kanë më vulnerabilitet në tregun e punës, domethënë, kriteri, në radhë të parë, për të përfituar është që personi të jetë i regjistruar pranë zyrave të punës.

Elementi i dytë, shumë i rëndësishëm, është se duhet të jenë të përfshirë shumë elemente të tjera si formimi në punë, këshillimi, informimi, intervistat në bizneset e caktuara, duhet të kesh qenë i papunë për një periudhë relativisht të gjatë përpara se të mund të përfitosh nga këto programe.

Në të gjithë gamën e të rinjve, të cilët mund të jenë pa punë, ne targetojmë ata që janë më vulnerabël dhe duhet ta mbështesësh financiarisht që ata të aktivizohen në tregun e punës.

Ne i kemi kategoritë e përcaktuara edhe në ligjin e nxitjes së punësimit, se kush mund të përfitojë. Janë personat me aftësi të kufizuara, prindërit kryefamiljarë, nënat që janë viktimat të dhunës dhe trafikimit, personat me aftësi të kufizuara, romët, egjiptianët e tjerë.

Një tjetër ndryshim shumë i rëndësishëm që po bëjmë për këto programe në këtë moment është edhe fakti se jo të gjithë kanë të njëjtat vulnerabilitete dhe programet nuk mund të jenë të gjitha identike. Është shumë e rëndësishme që për të gjitha vulnerabilitetet e individit ne të kemi paketa shtesë që e mbështesin këtë individ në tregun e punës.

Unë po shpjegoj programet duke vënë theksin te fakti se ne po punojmë me grupet vulnerabël. Të rinjtë si ju, deri diku kanë një lloj avantazhi në tregun e punës, se kanë arsimin e lartë, që deri diku tregon për një nivel më të lartë aftësish, nuk janë prioritet dhe nuk kanë vështirësi në integrimin në tregun e punës. Shpeshherë në kuadrin e fondeve të kufizuara, fokusi shpeshherë mbetet tek ata të cilët janë shumë më larg tregut të punës, megjithatë një program të ri që ne jemi duke dizenuar dhe në kuadrin e programeve të nxitjes së punësimit fillon vitin që vjen, është programi i vetëpunësimit.

Një vajzë foli për një *callcenter*, ku ka punuar disa herë. Ka shumë individë që mund të kenë provuar veten e tyre në dhjetëra vende pune. Në qoftë se ka dikush aftësi sipërmarrëse, është i gatshëm të angazhohet dhe të hapë edhe biznesin e vet, ne me fondet publike kemi parashikuar edhe një program të dedikuar për vetëpunësimin e atyre të rinjve, të cilët janë të interesuar dhe kanë aftësi sipërmarrëse.

Të gjitha këto lloj programesh janë aktualisht të afishuara te faqja e Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Kështu që unë do ju ftoj që të klikoni atje, megjithëse aty janë ende programet e vjetra, të cilat janë shfuqizuar, sepse ligji është shfuqizuar. Programet e reja fillojnë nga 1 janari.

Për mua mesazhi është shumë i rëndësishëm dhe duhet të ketë më shumë informacion për sa i përket natyrës së programeve të cilat duhet të jenë më të afishuara.

Mua më vjen shumë mirë që mesazhi vjen nga të rinjtë që thonë se ne duam të iemi të përditësuar në tregun e punës dhe unë e them këtë në mënyrë të vazhdueshme, që e vetmja garanci sot në tregun e punës për të ardhmen e të rinjve është që të mbetesh relevant duhet të jesh i përditësuar. Çdonjëri nga ne, që të mbetemi relevant në tregun e punës duhet të mësojmë në mënyrë të vazhdueshme gjëra të reja.

Unë mund të flas pa fund për ofertën publike të formimit profesional, ato janë kurse afatshkurta që variojnë nga 1-6 muaj dhe në shumicën e rasteve kanë komplet një profil profesional të një niveli të ulët dhe të mesëm, por është shumë e rëndësishme të nënvizojmë që paralelisht me ofertën publike ekziston edhe një ofertë e një game shumë të gjerë private e formimit profesional. Në qoftë se ne kemi 10 qendra publike, ka mbi 500 qendra private të formimit profesional të licencuara.

Nuk ka një regjistër publik, por është një ide shumë e mirë që kjo të bëhet në kuadër të një projekti. Ne kemi tentuar të krijojmë një portal ku gjithë oferta e formimit profesional të integrohet në një portal të vetëm.

Meqenëse ne jemi në fazën e rishikimit të faqes së SHKP-së, këtë komponent do të synojmë që ta integrojmë, edhe ofertën e qendrave private, edhe ofertën e qendrave publike.

Një tjetër element shumë i rëndësishëm është se ne kemi 10 qendra të cilat trajtojnë rreth 15 mijë persona në vit, ndërkohë që nevoja mund të jetë shumë më e lartë. Ne jemi duke ndërmarrë një hap shumë të rëndësishëm. Kurse afatshkurtra në vijim do të jenë në gjendje të ofrojnë edhe shkollat profesionale, domethënë të jemi në gjendje të zgjerojmë gamën edhe në numra, por edhe në cilësi, edhe në ofertë gjeografike të kurseve profesionale afatshkurtra.

Unë dëgjova këtu se edhe sektori privat duhet të jetë i angazhuar dhe vetë biznesi, vetë punëdhënësi të marrë përsipër një lloj angazhimi social në lidhje me këtë gjë.

Me evoluimin e sektorit privat kemi parë se ka eksperiencë pozitive në këtë drejtim. Unë do t'ju jap vetëm një shifër, thjesht më tepër si një mesazh për të rinjtë: Sot në themi që 1 ndër 5 të rinj është i papunë, pra kaq është shkalla e papunësisë për të rinjtë, afër 20%. Shumë nga të papunët duhet të jenë të rinj, por ama në qoftë se shkojmë te zyrat e punës sot dhe shohim përqindjen e atyre që janë të regjistruar të papunë, janë të rinj të grupmoshave 16-29 vjeç, që është standard ndërkombëtar, ndërkohë që ne kemi gjithsej nga 70 mijë të papunë të regjistruar te zyrat e punës, 12 mijë (plus-minus) janë të kësaj grupmoshe, që do të thotë se janë një numër shumë i vogël i të papunëve që shkojnë dhe trokasin te zyrat e punës. Kjo nuk është një përgjegjësi e të rinjve, por është një përgjegjësi e bashkëndarë, se edhe ne duhet të jemi shumë më tepër vizibël ndaj të rinjve dhe duhet të kemi programe atraktive për të rinjtë në mënyrë që ata të afrohen te zyrat e punës.

Unë këto kisha, pak a shumë, për pjesën e punësimit dhe të formimit.

Enver Roshi - Faleminderit!

Nga inspektorati, urdhëroni!

Irida Qosja – Në vijim edhe të fjalës së zëvendësministres do të desha të filloj me transparencën. Ishte një nga të rejat që diskutoi transparencën e institucionit. Për hir të së vërtetës, këtë vit inspektorati i punës ka bërë një hap shumë cilësor në raportin e transparencës së institucionit me publikun.

Do t'i ftoja të gjithë të rinjtë të vizitojnë faqen zyrtare ueb, *inspektoratiopunes.gov.al*, për të parë se sa transparente është, jo vetëm puna që bën inspektorati, por edhe informacioni i shtuar mbi të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësve dhe punëmarrësve.

Ndërkohë, edhe në medien sociale jemi aktivë, duke dhënë rezultatet në kohë reale të punës së Inspektoratit të Punës. Po në faqen tonë zyrtare është lehtësisht i mundur aksesimi dhe bërja e një ankese pa pasur nevojë të prodhosh asnjë letër, por bëhet thjesht në një formë kontakti, kushdo mund ta shkruajë dhe automatikisht ajo ankese merret për trajtim dhe po në adresën apo telefonin që ankuesi apo denoncuesi i një situate të caktuar lë në atë aplikim, i kthehet përgjigje brenda 10 ditësh.

Kemi trajtuar 600 raste denoncimesh qysh nga janari.

Inspektorati i Punës nga korriku deri në shtator, duke pasur parasysh që sezoni turistik përmban një informalitet të shtuar dhe gjithë ato elemente që përmendi një nga të rinjtë, që lidhen me problematikat të cilat shoqërojnë punësimin informale, kemi organizuar një plan operacional masash, rezultatet e të cilit i kemi bërë publike në adresën faqen tonë ueb dhe i kemi përditësuar.

9181 subjekte janë inspektuar dhe 2063 janë konstatuar informale. I vetmi diskutim është që Inspektorati i Punës i ka punëmarrësit mbi 18 vjeç dhe ndoshta në këtë kuadër ne nuk kemi të dhëna të sakta se sa nga këto kanë qenë kategoria e të rinjve, prandaj është operuar rast pas rasti për çdo punësim informal, është operuar me pezullimin e punës duke mos lejuar vijimin e punës, derisa kjo punë t'i kthehej ligjshmërisë, domethënë që ai punëmarrës të përfshihej në skemën e sigurimeve shoqërore dhe të lidhej një kontratë pune për të.

Sa i takon informalitetit këto subjekte kanë kaluar automatikisht si subjekte me risk të lartë për t'u bërë pjesë e programimit të punës në vijim të inspektorëve. Ajo që më bëri përshtypje nga diskutimi dhe që duhet ta diskutojmë, pavarësisht se e kuptoj që e kemi kohën shumë të shkurtër, por është mirë të thuhet, kishte të bënte me shkeljes e së drejtës për organizim.

I nderuar zoti kryetar, e drejta për organizim është e drejtë ligjore e individit, është vullnet, ligji e parashikon këtë dhe inspektorati është atje në rast se konstatohet që kjo e drejtë është shkelur, por denoncimi për shkeljen e kësaj të drejte duhet të vijë nga individët, të cilëve iu është mohuar kjo e drejtë, sepse është shumë e vështirë të verifikohet nga jashtë kjo situatë, kështu që merren rast pas rasti.

Për sa u takon organizimeve sindikale, si bashkimet vullnetare të punëmarrësve, sigurisht që ne konstatojmë se ka një nevojë të shtuar tregu që këto organizime të jenë më të fuqizuara, por për këtë ndoshta u bie barra të rinjve që të jenë më të informuar dhe t'i zhvillojnë këto organizime sindikale, sepse Inspektoratin e Punës do ta kenë në krah. Ne kemi nevojë për sindikata pune të fuqishme që të bëjmë më mirë punën tonë.

Enver Roshi – Faleminderit!

Irida Qosja – Faleminderit juve!

Enver Roshi - Klodi, kishe kërkuar fjalën?

Klodiana Spahiu – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, unë do të doja përgëzoja Qendrën për të Drejtat në Punë dhe të gjithë të rinjtë që janë sot këtu, sepse me të vërtetë ishte një seancë dëgjimore model për t'u marrë shembull jo vetëm nga ne, por edhe nga përfaqësuesit e ministrisë, sepse problematikat që ngritën të rinjtë ishin shumë koncize dhe shumë të sakta pa humbur kohë për askënd nga ne.

Me sa kuptoj ne duhet t'u japim një zgjidhje të gjitha problematikave që ngrenë të rinjtë, nuk e di se si, ndoshta me një bashkëpunim me ministrinë dhe Inspektoratin e Punës, sepse kërkimin e karrierës e mbulon Komisioni i Arsimit, prandaj kemi këtu zonjën Adelina, anëtare në Komisionin e Arsimit. Këtu duhet vënë me të vërtetë fokusi, sepse përgjithësisht institucionet private e kanë më të mirë organizuar dhe ne duhet të mundohemi që të rinjtë, para se të mbarojnë, të kenë një këshillim shumë të mirë në karrierë, për të zgjedhur drejtimin dhe rrugën e tyre.

Problematika e dytë që ngritën kishte të bënte me punësimin informal. Përfaqësuesit me të drejtë na bënë një përshkrim të punës së deritanishme, ne kemi pasur edhe një raport të fundit me punë informale në të gjithë Shqipërinë dhe doli që ka rajone me shkallë të lartë informaliteti, përfshi dhe Durrësin, nuk e di pse, ndoshta për shkak të turizmit dhe të rritjes së punësimit në sezonin e verës. Shpresoj që kjo të vijë drejt eliminimit, sepse është e pamundur të zerohet, por që të shtohet në një moment kur ne rrisim kërkesën për të frenuar informalitetin, nuk shkon, pra është pak e vështirë. Besoj se arsye për këtë ka qenë bumi i turistëve këto 2-3 vitet e fundit.

Më shqetëson problematika e ngritur në lidhje me të punësuarit në *Call Center*, të cilën e kam dëgjuar edhe nga takimet që kam pasur me djemtë dhe vajzat që punojnë aty. Ka të bëjë me shëndetin. Unë them se Inspektorati i Punës në bashkëpunim me Inspektoratin Shëndetësor duhet të jenë të organizuar, nuk e di se si, por mbase Instituti i Shëndetit Publik duhet të bëjë të mundur një studim, sepse është një numër shumë i madh i të rinjve shqiptarë që punojnë në *Call Center*. Nuk mund të flas për paralizë faciale, sepse është ca e ekzagjeruar, por do të thosha ezaurimi për shkak të punës dhe orareve të zgjatura mund të jenë një faktor që ndikon në shëndetin mendor të tyre. Megjithatë nuk mund të flasim pa baza shkencore.

Meqenëse vitet e fundit numri i të rinjve të punësuar në *Call Center* është shtuar shumë dhe besoj se është një alternativë e mirë derisa të gjejnë një variant pune më të përshtatshëm, ne duhet ta ndërmarrim një nismë të tillë, duke menduar për shëndetin e tyre. Mirë është të

bëhet një studim i përbashkët i Inspektoratit të Punës dhe Inspektoratit Shëndetësor ose Institutit të Shëndetit Publik.

Problematika tjetër e ngritur ka të bëjë me ratifikimin e konventës, e cila është recente, kështu që besoj se kur të vijë në parlament pa dyshim do të ratifikohet, por nuk mund të ratifikohet kur të duam ne, pasi ka procedura kohore të caktuara, që do t'i zbatojmë edhe ne.

Në fillim të fjalës së përfaqësueses, meqenëse drejtori Ekzekutiv nuk ishte, ju thatë që keni bërë...

Enver Roshi – Drejtori është.

Klodiana Spahiu – Në rregull, kërkoj ndjesë!

Ju thatë që keni bërë një studim, në lidhje me problematikat që ka punësimi i të rinjve në Shqipëri, unë do të doja të kishim të dhënat e studimit tuaj dhe përpara se të vini në seancë dëgjimore, do të ishte mirë t'i lexonim dhe të kishim një informacion paraprak edhe për problematikat që kanë të rinjtë, pasi do të ishte më e eficiente si për ju, ashtu edhe për ne, por edhe për përfaqësuesit e Inspektoratit dhe të Ministrisë, sepse duhet të dinë ku do të fokusohen. Nëse Inspektorati jep rezultate për gjithë punën që ka bërë, ne duhet të fokusohemi në target-grupin që kemi sot, pra te të rinjtë. Do t'ju sugjeroja që kur të kërkonin seanca dëgjimore, dhe ne iu përgjigjëm shumë shpejt thirrjes së kryetarit për ta zhvilluar këtë seancë dëgjimore me dëshirën e mirë për të qenë sa më pranë të rinjve, të na i sillni ato të dhëna. Mund ta bënim edhe një javë më pas, por do të ishte më e eficiente kështu.

Në fund ju përmendët disa qytete që i kanë të organizuara grupet e të rinjve dhe shpresoj të shtohen, sepse sa më mirë të jenë të organizuar të rinjtë për kërkesat e tyre aq më shumë do të dëgjohet zëri i tyre, jo vetëm për të drejtat në punë, por për çdo të drejtë.

Faleminderit!

Enver Roshi – Faleminderit!

Po, zonja Adelina.

Adelina Rista – Faleminderit, zoti kryetar!

Çdo dëgjese ka rëndësinë e vet, sepse zakonisht ne bëjmë dëgjesa me të gjitha grupet e interesit kur kemi një projektligj, por bëjmë edhe dëgjesa të veçanta me grupe të ndryshme, që parashtrojnë problematikat e tyre, duke na nxitur të mendojmë se si mund t'i zgjidhim nëpërmjet ligjshmërisë, pra të hartojmë ligje të tilla që problematikat të minimizohen.

Jemi këtu me të rinjtë dhe kuptohet që ata meritojnë vëmendje, sepse janë e ardhmja. Klodi i kapi një për një të gjitha dhe nuk na la asnjë mundësi për t'i shtruar, kështu që nuk dua të kaloj në përsëritje.

Unë dua t'ju përgëzoj për mënyrën koncize me të cilën shtruat problematikat tuaja më pikante, pasi seanca ishte tepër e ngjeshur! Dua të falënderoj zëvendësministren, e cila mbulon problemet e punësimit, çështjet e arsimit dhe formimit profesional në ministri! Ne do të kemi një dëgjese tjetër te Komisioni i Edukimit dhe mua kjo dëgjese më shërbeu për ta ngritur si çështje edhe atje.

Për t'i rënë shkurt, doja një përgjigje *flesh* nga të rinjtë. Unë jam deputete e qytetit të Fierit dhe e kemi organizatën “Epoka e Re”, e cila merret me problemet e të rinjve me projekte nga më të ndryshmet në funksion të problemeve të të rinjve. Unë dua të di nga të rinjtë se cili prej tyre vjen nga arsimi profesional. A ka ndonjë? Le ta ngrejë dorën! Ju dëgjova me vëmendje, prandaj bëra pyetjen. Askush nuk vjen nga arsimi profesional.

Unë jam deputete që nga viti 2013 dhe sapo erdhi kjo qeveri në pushtet ne kaluam në parlament një ligj shumë të rëndësishëm atë “Për arsimin dhe formimin profesional” për aftësimin e të rinjve dhe për të përshtatur punësimin e tyre me tregun e punës, pra kërkesë-oferta. Më pas kemi miratuar ligjin për nxitjen e punësimit, që është në funksion të kësaj problematike që po dëgjojmë sot. A jeni të njohur me ligjet që miraton parlamenti dhe që ju interesojnë? A jeni të njohur me të drejtat që përfitoni? Në këto qendra, ku ju grumbulloheni, po marr Epokën e Re në Fier, a keni bërë ndonjë veprimtari që të njiheni me të rejtat që dalin në ligjshmëri për sa i përket punësimit dhe nxitjes së punësimit? Unë mendoj se duhet të bëni, sepse ju folët për mungesë informacioni.

E pra, nuk dini të orientoheni, sepse keni mungesë informacioni dhe shpesh mungesa e informacionit ju nxjerr pengesa për orientimin në tregun e punës.

Gjithsesi unë ju falënderoj për këtë dëgjese sot, se ishte shumë e rëndësishme! Ju ngritët problematikën më të madhe, këshillimin dhe edukimin e karrierës, që i takon arsimit parauniversitar, ju thatë që në arsimin jopublik ka zyra të veçanta për këshillimin e karrierës dhe kërkoni që këtë ta ketë edhe arsimi publik. Pra, ishin disa gjëra të rëndësishme.

Ju falënderoj edhe një herë për dëgjesën!

Unë si deputete, bashkë me kolegët e mi, besoj se do të kemi vëmendjen e duhur për të zgjidhur shumë nga problematikat tuaja.

Faleminderit!

Enver Roshi – Faleminderit!

Po, Almira.

Almira Xhembulla – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë e falënderoj përfaqësuesen e Qendrës së të Drejtave në Punë për të gjithë përmbledhjen që bëri, por kam një falënderim të veçantë për mundësinë që iu është krijuar të

rinjve, të cilët ishin shumë të saktë dhe koncizë në atë që kërkuam! I uroj shumë suksese në karrierën e tyre!

Pa diskutim është puna dhe angazhimi ynë që të krijojmë një mjedis ligjor të përshtatshëm për t'u dhënë mundësisë të gjithë të rinjve të kenë një të drejtë pune, si dhe të kenë hapësira për të zhvilluar karrierën e tyre. Dua të them se një hap shumë i mirë është ligji për rininë, i cili trajton disa nga çështjet që ju diskutuat, ai po diskutohet në parlament, ka kaluar në Komisionin e Ligjeve dhe presim ta kalojmë edhe në Komisionin e Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik. Shpresoj shumë që ju të keni qenë pjesë e diskutimeve për dhënie mendimi për këtë projektligj nëpërmjet organizatave të ndryshme të përfshira. Kështu që ky është një lajm i mirë edhe për ju që jeni pjesë e dëgjësës.

Çështja tjetër është që ne vijmë direkt pas një dëgjese të bërë me DAP-in dhe në diskutimin me ta informacioni që kërkuam ishte nisma e nxitur nga Kryeministri për punësimin e studentëve ekselentë. Një përqindje shumë e mirë e vendeve të punës vakante të njoftuara nga DAP-i u morën në mënyrë të drejtpërdrejtë nga studentët ekselentë dhe mendoj se ky ishte një hap shumë i mirë i qeverisë për t'u krijuar mundësi direkte të gjithë studentëve dhe njëkohësisht për të nxitur interesin e të rinjve, sidomos më të mirëve, për të jetuar dhe punuar në Republikën e Shqipërisë.

Një çështje tjetër që diskutuam, që lidhet me këshillimin e karrierës, ishte që ne i kërkuam DAP-it të jetë proaktiv në konsultime dhe diskutime me universitetet dhe me institucionet parauniversitare, që ata të orientohen drejt, sepse ata janë një zyrë informacioni e besueshme për të rinjtë në të gjitha ato fusha ku ne nuk kemi ekspertë. Shumë vende pune janë vakante në sistem për shkak se nuk kemi në treg inxhinierë, informaticienë etj. nuk po hyj në detaje teknike. Këtu lind ideja dhe shtysa që t'i orientojmë të shkojnë në ato degë, që, për fat të keq, kanë mbetur me një numër të vogël studentësh, por që janë shumë të kërkuar në tregun e punës. Pra, edhe këtë gjë e kërkuam nga DAP-i dhe ndërkohë e shtymë edhe për sa u përket institucioneve të tjera. Pa dyshim çdo gjë që u diskutua është shumë më vlerë dhe unë e falenderoj edhe zonjën Sorensen, sepse, përveç faktit që është zëvendësministre e Financave, është shumë aktive për sa i përket çështjes së nxitjes së punësimit nëpërmjet arsimit profesional. Ne do të kemi fatin të bëjmë një dëgjese tjetër dhe të fokusohemi aty, por për sa i përket çështjes së edukimit gjatë gjithë jetës unë do të doja që edhe ju si qendra ta merrni në konsideratë, sepse është e rëndësishme të koordinojmë.

Më vjen mirë që keni qenë të vëmendshëm ndaj zhvillimeve ndërkombëtare dhe pikërisht ndaj axhendës së ILO-s, e cila është një organizatë që ka prioritet çështjet e të drejtave në punë dhe e fokusuar tek teoritë.

Gjithashtu, ne kemi një komision koordinimi që merret me zhvillimin e qëndrueshëm të mijëvjeçarit, kështu që do të koordinojmë edhe me ta për ta miratuar këtë rezolutë.

Ju komplimentoj për prezantimin e sotëm! Do të jemi në kontakt, sepse besoj se drejtuesit e komisionit do të jenë proaktivë për ta çuar këtë çështje përpara.

Ne duhet të largohemi, sepse kemi një mbledhje tjetër komisioni.

Faleminderit!

Enver Roshi – Faleminderit! Mund të vazhdoni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do t’ju jap fjalën pas doktor Ilirit.

Ilir Pendavinji – Dua t’ju përgëzoj për iniciativën dhe për aktivizimin e të rinjve në këtë seancë të rëndësishme.

Në fakt, problematikat e të rinjve nuk janë vetëm këto që diskutuan të rinjtë, por janë edhe ikja masive e të rinjve, tendenca që kanë për të gjetur punë jashtë shtetit me rroga më të mira, për nivel jetese më të lartë e të tjera. Prandaj, ne, vendimmarrësit, duhet të mendojmë seriozisht për hapjen e vendeve të reja të punës, për mundësitë që të rinjtë ta shikojnë zgjidhjen në Shqipëri dhe jo për të ikur jashtë. Të gjitha studimet që janë bërë tregojnë një ikje të madhe të të rinjve, e cila është mbase legjitime. Kjo çështje duhet të jetë në fokus të këtij komisioni dhe të të gjithë ligjvënësve.

Unë dua të flas për aktet nënligjore të ligjeve, që të rinjtë e theksuan, kurse kolegët jo. Ne kemi bërë ligje shumë të mira, por akte nënligjore për zbatimin e tyre ... Pasi mbarojnë shkollën të rinjtë vihen në vështirësi për t’u punësuar, sepse ju kërkohet eksperiencë. Ku duhet ta marrin eksperiencën? Për këtë arsye para disa viteve u bë ligji “Për vullnetarizmin”, ku të gjithë kemi qenë pjesë e diskutimeve, me qëllim që të gjithë të rinjtë të kenë mundësi të marrin eksperiencë në profesionin e tyre. Në funksion të tij, ky komision duhet të bëjë një seancë dëgjimore me ministrinë për çështjen e akteve nënligjore të ligjeve që ne kemi kaluar dhe që për zbatimin e të cilëve nuk kemi asnjë informacion, të cilat nuk kalojnë më nga ky komision, por nga Këshilli i Ministrave, por edhe ...

Enver Roshi - Më fal, kompetencë e Ministrisë së Financave është kjo?

Ilir Pendavinji – Po, të punës.

Për sa i përket edukimit në karrierë, vërtet zonja Rista foli për të rinjtë që duhet të drejtohen drejt shkollave profesionale (kjo është trend në të gjithë botën dhe ne duhet të shkojmë drejt këtij trendi), por ama momenti që të rinjtë duhet të zgjedhin të shikojnë në shkolla profesionale është klasa e nëntë. Çfarë bëhet për edukimin në karrierë duke nisur që nga shkolla

9-vjeçare? Edukimi në karrierë është shumë i rëndësishëm për këta të rinj, sepse shikoj që të gjithë janë bërë juristë, filozofë, sociologë e të tjera.

Kam pasur problematika që në vitin 2013, kur u bëra deputet për herë të parë, me të rinjtë që më kërkonin punë dhe e shikonin deputetin si mënyrën dhe rrugën e punësimit kryesisht në shtet. Të gjithë ishin shkolluar kryesisht në shkenca sociale, mësuesi dhe infermieri. Infermiera është treg i madh i punës, por shumica e tyre kishin mbaruar mësuesi, cikël të ulët, gjuhë-letërsi dhe filozofi-sociologji. Bile, kam një rast në familje, pyeta një familjar timin pse e zgjodhe filozofinë? Do të bëheni të gjithë filozofë? Ndërkohë, vendet e punës në shtet për filozofi, sepse të gjithë kërkojnë të bëhen mësues filozofie në shtet, dy ose tre vende mund të jenë në një shkollë të mesme. Mesatarisht mbaronin 30 veta çdo vit shkollor, të cilët më pas nuk kishin mundësi punësimi. Në fakt, këta e kanë bërë shkollën e lartë, por për një profesion që ata nuk gjejnë dot punë. Kështu që duhet të punojnë kamarier. Kjo është një nga këshillat e mia për të rinjtë, por këtë çështje duhet ta trajtojmë ne, ministria dhe të gjitha instancat që përgjigjen për këtë pjesë.

Faleminderit!

Enver Roshi – Para se t'ju jap fjalën juve, dua të them edhe unë diçka.

Ju falenderoj për mendimet, angazhimin tuaj qytetar dhe që keni sjellë këtu të rinj nga një pjesë e mirë e rretheve, ku problematika e punës është shumë serioze. Ne si komision parlamentar, por edhe si deputetë jemi të angazhuar si e si t'u vijmë në ndihmë juve nëpërmjet hartimit të ligjeve, por edhe akteve nënligjore. Doktor Iliri tha me të drejtë se ka tre vjet që ka dalë ligji, por nuk kanë dalë aktet nënligjore. Kjo është përgjegjësi e ministrisë dhe Inspektoratit të Punës që duhet ta zbërthejnë këtë gjë. Nga eksperiencia ime unë them që tregu i punës nuk përputhet me ata që mbarojnë fakultetin apo shkollat.

Për shembull, dhjetë vjet më parë unë studiova tregun e punës dhe hapa degën e shëndetit publik në fakultetin e mjekësisë. Tregu i punës ishte për 20 studentë, ndërkohë në 4 vjet erdhën 400 studentë. Pra, nuk kishte treg pune. U detyrova të mbyllja degën e shëndetit publik për disa vite vetëm që të thithte tregu. Çfarë ndodh sot me tregun e mjekësisë? Ka dhjetëra studentë që mbarojnë për teknikë laborator, por nuk ka treg pune, ka dhjetëra studentë që mbarojnë për imazheri, por nuk ka vende pune, dhjetëra studentë që mbarojnë për fizioterapi, por s'ka vende pune. Këto degë janë të hapura në të gjitha rrethet. Ndërkohë, ka treg pune për infermierë dhe mjekë, sepse është tregu i jashtëm. Nuk ka përputhje me çfarë studiojnë dhe tregut të punës. Flas për universitetin.

Për sa i përket arsimit profesional, është bërë shumë punë për këtë çështje. Ka disa shkolla profesionale private që ngelin studentët, sepse çdo rimarrje në provim paguhet 50 euro,

ndërkohë nuk e lënë studentin të prekë kompjuterin, telefonin apo të mjete të tjera. Pra, të kontrollohen shkollat profesionale 1 dhe 2-vjeçare, sepse, sinqerisht, kemi shumë ankesa nga prindër, të cilëve ju ngelin fëmijët në klasë. Ne nuk themi që të ulet kërkesa e llogarisë, por ai mbaron një shkollë profesionale për të dalë në treg, jo për t'u bërë inxhinier ndërtimi apo inxhinierë elektronike.

Më serioze për mua është mjekësia e punës. Dikur mjekët e ndërmarrjeve kryenin një volum pune të madhe dhe rrinin pranë punës, kurse sot këto janë bërë vetëm për të lidhur një kontratë për të marrë rrogën, kurse problematikat e punonjësve të ndërmarrjes nuk ndiqet. Duhet një bashkëpunim midis Inspektoratit të Punës ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe shtetërori, por edhe i punës, sepse ka siguri në punë ...

Ju keni siguri në punë, për shembull. Numri i aksidenteve në punë është akoma i lartë, edhe pse është bërë përmirësim

Objekti juaj është punëtori dhe shëndeti i tij. Në *call center* është problemi i shikimit, dëgjimit, kordave të zërit, lodhjes, stresit, pagjumësisë. Është një gjë e madhe për t'u vlerësuar. Neve na mungon kjo. Na sillni ligjshmërinë për ta zgjidhur këtë gjë, që të kemi mjekë të dedikuar për ndërmarrjen. Në fakultetin e mjekësisë është mbyllur prej kohësh kualifikimi për mjekët e ndërmarrjeve ose mjekësinë e punës.

Shpeshherë ne ngelemi në nivel akademik. Nuk hapim dot kurse 1-vjeçare, sepse duhet bërë 3 ose 4-vjeçar. Ne jemi në ndihmë të njerëzve, bëjmë politikë për t'u ardhur në ndihmë njerëzve dhe ndërmarrjes. Një ndërmarrje e madhe si KURUM-i me 500-600 punëtorë duhet ta ketë mjekun 24 orë prezent për të ndjekur përditë me kartelë klinike gjithçka për shëndetin e punëtorëve, të bëjë kontrollin e punëtorëve për ndotësit që janë në mjedis, të bëjë analizat e punëtorëve për të monitoruar gjendjen shëndetësore të punëtorëve që janë aty. Vetëm kështu mund të ecim përpara. Mjeku të marrë lekët aty dhe të shkoj të punoj në vend tjetër, nuk shkon. Duhet që kjo situatë të zgjidhet, sepse është emergjente. Ngrihet një pikëpyetje e madhe për ne se si do ta bëjmë këtë gjë. Presim mendime, jo vetëm nga shoqëria civile (e falenderoj Enidën dhe Edin), por edhe nga Ministria e Financave, Inspektorati i Punës dhe i Shëndetësisë për ta zgjidhur këtë çështje, sepse është një problem shumë serioz. Këtë e them në mënyrë shumë të sinqertë. Kur shkojmë nëpër ndërmarrje ... Është shumë shqetësuese çështja që punëtorët kanë probleme shëndetësore dhe ne nuk dimë gjë fare.

Në Mjekësinë e Punës në Serbi kishte 25 nënspecialitete të mjekësisë së punës. Ne këtu kërkojmë një mjek pune të përgjithshëm. Nuk po kërkojmë specialistë për sytë, veshët,

otorinolaringolog, shtyllën kurrizore e të tjerë. Duhet bërë një vlerësim i kushteve të punës dhe i ndikimit të kushteve të punës tek individët. Kjo është një sfidë për ta përballuar.

Unë ju falenderoj të gjithëve për këto mendime të vyera! Nuk i mohojmë arritjet tuaja, por ne bëjmë një oponent të singertë, sepse jemi në shërbim të njerëzve. Neve na dhimbset njerëzit, punëtorët. Me rrogat e paketa që marrin mbajnë veten e tyre, familjen dhe shpeshherë janë të neglizhuar nga kujdesi shëndetësor apo diskriminimi që u bëhet në punë. Të mos harrojmë problemet e tjera që i ngiten shumë mirë të rinjtë.

Faleminderit!

Edlira, kishit diçka për të thënë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër.

Edlira Bode – Për ta bërë pak më konkrete, meqenëse doni të merrni fjalën, ndoshta do të na ktheni edhe përgjigje.

Ju thatë se jeni bërë më shumë transparentë, që keni trajtuar mbi 600 ankesa që nga janari e deri tani, që keni luftuar informalitetin dhe rreth 2000 subjekte, nga 9000 që ju keni inspektuar, kanë rezultuar informale. Kur ju bëni këto inspektime, kontrolloni nëse ka mjekë dhe mjaftoheni me kaq apo kontrolloni nëse mjeku ka kartela mjekësore për çdo punonjës, nëse në ato kartela ka apo jo shënime periodike mbi gjendjen shëndetësore të këtyre punonjësve, nëse në ato kartela ekziston një ekzaminim, jo thjesht vizitë, periodik për problematika të caktuara? Është e vërtetë që ata që punojnë në *call center* mund të përballen me ulje të dëgjimit, marrje mendsh, infeksione të veshit, paralizë faciale, meqenëse e përmendi doktoresha. A bëhen aty ekzaminime periodike për këto gjëra.

Enver Roshi – Më fal, Edlira! Për shembull, kontrole për fenolët në fabrikat e këpucëve? Punëtorët helmohen dhe kanë anemi.

Edlira Bode – A ekziston një listë që duhet ta kenë inspektorët me vete kur shkojnë për kontroll dhe si ju ka rezultuar kjo? Dakord që kontrolloni informalitetin, por po shëndetin dhe sigurinë në punë e kontrolloni?

Kryetar, nëse jeni dakord, unë do të doja që, mbasi folëm të gjithë ne, të dëgjoja nga të rinjtë nëse kanë ndonjë reflektim dhe a u bëri përshtypje ndonjë gjë nga këto që ne thamë?

Enver Roshi – Ndoshta Enida dhe Edisoni ...

Enida Mjeshtri – Në këtë dëgjese ne kemi mbledhur disa grupe të rinjsh, problematikat kryesore dhe nuk kemi dashur t'i censurojmë.

Ishte një dëgjese e singertë, sepse ata nuk erdhën të censuruar, edhe pse qendra, në shumicën prej çështjeve që ngritën të rinjtë, ka pasur informacionin e nevojshëm, sepse në Shqipëri është një qendër e specializuar për të drejtat e punës.

Ajo që neve na ka bërë shumë përshtypje tek të rinjtë me të cilët jemi përballur është mungesa e informacionit jo vetëm për vendet e punës, por si duhet ata t'i afrohen një pune, e cila t'u sigurojë mirëqenie, shëndet, rritje profesionale dhe dinjitet në marrëdhëniet e punës.

E kemi prekur këtë çështje dhe kemi dashur të sjellim të rinjtë për të përballur këtë problematikë që diskutoam, e cila nuk është e vogël. Ju falënderojmë shumë, se gjetëm mbështetjen e secilit prej jush! Ju treguat më së miri që jeni të zgjedhurit e gjithë të rinjve, sepse secili prej tyre ka votuar në këtë legjislaturë.

I rëndësishëm për ne (dua ta theksoj këtë) është fakti që, nëse nuk do të rregullojmë mënyrën si funksionon puna në Shqipëri, do të kemi shumë më tepër një brez pune të djegur, njësoj siç është pjesa më e madhe e moshës sonë. Ne e nisëm fushatën... Është brez i djegur, sepse ngarkesa e punës, futja në një treg të lirë ekonomik, shpeshherë të parregulluar, na ka vendosur përballë përgjegjësisë që të punojmë dhe të rrisim mirëqenien tonë ekonomike.

Ne shohim që secili prej të rinjve është i orientuar drejt punës. Ky është një shembull shumë i mirë i shqiptarëve dhe i këtyre të rinjve, por nëse kjo punë nuk do të rregullohet dhe, e përsëris, nëse nuk do të zbatohen standardet e punës, nëse nuk do të punohet fort që ky punësim të jetë i denjë dhe t'u krijojë mundësi shqiptarëve të rinj të ndihen dinjitozë në marrëdhëniet e punës, ne do të kemi një brez që do të lodhet, do të krijojë zakone profesionale dhe një kulturë pune që nuk do t'i shërbejë më as zhvillimeve ekonomike dhe shoqërore të Shqipërisë, as futjes së saj në tregun e madh ekonomik europian, drejt të cilit jemi çelur dhe shpresojmë që shumë shpejt të bëhemi të barabartë.

Prandaj është shumë e rëndësishme që na mbështetët.

Në përmbyllje, nuk do të doja të thosha ndonjë gjë tjetër.

Kush prej të rinjve...?

Po, Jurgen mund të flasësh.

Jurgen Troka– Përshëndetje!

Do të doja të flisja në emër të target-grupit tim të të rinjve. Ndihem i mirëpërfaqësuar që ju i keni marrë parasysh kërkesat tona, por do të doja të kishte një vijimësi të kësaj që ju thatë sot, të mos harrohet dhe të mos mbetet në mbledhjen e sotme, sepse grupi i të rinjve që përbën sot strukturën e popullsisë shqiptare është i shkolluar, i zgjuar dhe di të vendosë.

Puna juaj si deputetë, se fundja ju punësoni edhe nga ne të rinjtë, varet shumë në atë që bëni. Nëse ju nuk na ndiqni, dijeni se do të përballeni me një refuzim të të rinjve ndaj punës suaj.

Shumë faleminderit!

Enver Roshi – Faleminderit!

Duhet të flisni shumë shkurt.

Emri juaj?

Angjelo Ahmati – Angjelo Ahmati.

Dëgjova pak më parë nga deputetja, e cila ishte pjesë e Ministrisë së Arsimit, se keni marrë një nismë shumë të mirë për studentët ekselentë. Ajo foli vetëm për studentët ekselentë, jo për joekselentët, me një mesatare normale, të mesme. Nuk dhatë ndonjë shembull, nëse ka ndonjë iniciativë nxitjeje për ata studentë. Folët vetëm për studentët ekselentë dhe nuk morëm një përgjigje ideale për kërkesën që shtruat. Kisha edhe një kërkesë tjetër, por për shkak të kohës nuk po e them.

Enver Roshi – Thuaje shkurt!

Angjelo Ahmati – Kërkesa tjetër ishte për sa u përket bizneseve që ushtrojnë punën e tyre në Jug. Ishin 2000 të kapura. Mendoj se vërtet janë 2000 të kapura, por ka biznese që hapen shumë shpejt dhe vazhdojnë të punojnë kundër ligjit. Mendoj se duhet të ketë masa më të rrepta, që të paktën herën e parë kur të kapen duke shkelur ligjin, të mos kenë iniciativa për të vazhduar punën kundër ligjit.

Faleminderit!

Enver Roshi – Faleminderit!

Po, keni 30 sekonda kohë.

Flogerta Driza – Përshëndetje të gjithëve!

Quhem Flogerta. Doja të shtoja vetëm një element shumë të rëndësishëm. Duhet të mendoni në mënyrë konkrete për të rinjtë, sepse ne jemi duke u larguar. Këtu kam parasysh kategorinë nga mosha 21-32 vjeç. Numri i të rinjve që po largohen është shumë i madh. Po nuk pati të rinj, një vend nuk ka të ardhme, nuk ka taksapagues, nuk ka votues dhe nuk ka shtet. Kështu që duhet të merrni konkretisht në konsideratë çdo problematikë që ata kanë dhe të jepni mundësi më të mira për punë për të rinjtë.

Faleminderit!

Enver Roshi – Faleminderit!

Edison, të lutem, sa më...! A keni bërë ndonjë dokument, në kuptimin e rekomandimeve të shkruara, apo do t'i bëni më vonë për t'ia dërguar komisionit?

Edison Hoxha – Faleminderit, kryetar!

U thanë shumë gjëra këtu, edhe nga kolegja. Doja t'ju falënderoja ju, si kryetar, dhe të gjithë anëtarët e komisionit, jo vetëm për mundësimin e kësaj seance dëgjimore, por edhe për angazhimin e padiskutueshëm që shprehët në këtë seancë në mbështetje të këtyre çështjeve, sepse ne diskutojmë jo vetëm problematikat, por çdo lloj çështje. Edhe një shembull pozitiv është mirë (ndoshta në një moment tjetër) ta diskutojmë, me qëllim që të shumëfishohet dhe të përqafohet edhe nga të tjerë.

Ne jemi organizatë e specializuar për të drejtat në punë. Ne punojmë në terren dhe kjo është shumë e rëndësishme. Mendoj se kjo është e nevojshme edhe për Kuvendin, edhe për institucionet shtetërore, sepse mund të marrim informacion në terren se çfarë ndodh me të drejtat e punës. Kemi vullnetin e plotë që këtë informacion ta përcjellim ashtu siç është realisht, në çdo institucion, përfshirë edhe Kuvendin, me qëllimin e vetëm që realiteti të dalë siç është dhe këto të diskutohen (siç po diskutohen sot) e të gjejnë rrugën e zgjidhjes. Sigurisht, ky është një proces, nuk është një destinacion. Shumë problematika zgjidhen, dalin të tjera, pra është një proces që do të vazhdojë, por në qoftë se ne do të kemi angazhimin e përbashkët të të gjithëve, si ky i sotmi, mendoj se shumë çështje mund t'i adresojmë. Institucionet me njëri-tjetrin, shoqëria civile, sindikatat me çështjet e punës, duhet të përfshihen dhe të japin kontributin e tyre.

Ne kemi studime dhe çështje të caktuara, që mund t'ju përcjellim, përveç çështjeve që u diskutuan sot, që patjetër do t'ju sjellim më pas me shkrim.

Pra, ne, kolegë të tjerë dhe organizata të tjera, kemi këtë ftesë ndaj komisionit, që këto lloj diskutimesh të jenë të vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Çështjet e punës, përveç çështjeve të punësimit (jo thjesht punësimi, por standardet e punës), të jenë të përfshira në agjendën e Kuvendit dhe të institucioneve, sepse nëse nuk do të kemi përqendrim të vëmendjes te standardet e punës, atëherë nuk do të kemi asnjëherë punësim të qëndrueshëm. Në qoftë se nuk do të kemi punësim të qëndrueshëm, nuk do të kemi asnjëherë të rinj që punësohen dhe e kanë mendjen të rrinë këtu, por ata do të kenë thjesht diçka tranzitore, sa t'u krijohet mundësia për të ikur jashtë.

Këtë synojmë nëpërmjet kësaj fushate, që do të vazhdojë edhe në disa qytete (përveç këtij aktiviteti janë parashikuar edhe disa të tjera). Ne e bëjmë këtë me kaq ngut, me të drejtë u përmend nga një deputete e nderuar...

Enver Roshi - Klodi...

Edison Hoxha - ...sepse ne donim të kapnim datën e shënuar 7 tetor, Ditën Ndërkombëtare të Punës së Denjë. Donim ta fillonim nga kjo. Për shkak të angazhimeve të

tjera filloi pak me vonesë, por kjo ishte arsyeja pse donim ta fillonim tani dhe nuk mund ta zgjasnim pak më tutje. Do ta kemi në konsideratë dhe është shumë e drejtë kërkesa që u bë këtu edhe nga përfaqësuesit e institucioneve, që duhet një informacion i qartë paraprak, i detajuar, që të diskutohet në mënyrë sa më shteruese.

Faleminderit!

Enver Roshi – Faleminderit!

Problematika e punës dhe e punësimit në Shqipëri është shumë e madhe, shumë e gjerë, ka shumë elemente dhe ne jemi të angazhuar për të pritur mendimet tuaja.

Mendoj që krahas Komsionit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë, të keni kontakte edhe me institucionet e tjera, sepse kjo është një qasje shumësektoriale. Mund të organizoni edhe një konferencë, ku të ftohen të gjitha aktorët dhe mund të vijmë edhe ne të flasim, që t'i bëhet e ditur opinionit publik, rinisë dhe organizatave si të rritet punësimi i të rinjve apo të përmirësohen standardet e punës.

Ju falënderoj për ardhjen këtu dhe mendimet e vyera që dhatë! Jeni të mirëpritur çdo herë dhe keni angazhimin tonë në parlament e kudo!

Ju të inspektoratit do të qëndroni pak.

Me ju mbaruam.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA